

2 Personeli i huazuar dhe puna temporale
Kontrata e re Kolektive e Punës nga 1 janari 2019

3 Greva e grave dhe dita e aksionit për barazi në paga Me 14.06.2019
kërkohet më shumë respekt e pagë e kohë

4 Vdiq aktivisti dhe sindikalisti Remo Schädler Kontribuues i shkëlqyer në lami të ndryshme

Nr. 1 | shkurt 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Dumpingu në paga

Problemi me dumpingun në paga



Pamje aksioni sindikalist për mbrojtje të pagave dhe kushteve të punës para Parlamentit federal të Zvicrës

Dumpingu në paga në Zvicër është bërë përditshmëri. Rastet skandaloze të dumpingut në paga gjithnjë e më shpesh zënë titujt e gazetave. Kjo është vetëm maja e ajsgbergut. Dumpingu në paga është një problem i përgjithshëm që përfshinë gjithë vendin dhe në shumë sektorë. Ai ka dalë krejtësisht nga kontrolli. Andaj janë të nevojshme masat anësore shtese.

Pasi, nëse dumpingu në paga bëhet normalitet, kjo i dëmton punëmarrësit. Dumpingu në paga nxitë një përkeqësim në lëvizje, e cila u venë nën presion shumë ndërmarrje, vende të punës dhe paga. Pasoja: ndërmarrjet korrekte duhet të zvogëlojnë vendet e punës dhe ato të trajnimit, ndërsa pagat ulen.

Nevojiten instrumente efektive kundër dumpingut në paga

Në Zvicër autoritetet zyrtare janë përgjegjëse për zbatimin e kushteve të pagave dhe të punës. Mirëpo, mungojnë instrumentet, për të vepruar kundër dumpingut në paga. Firmat që bëjnë shkeljet – edhe kur kapen në vepër – praktikisht kanë mundësi të vazhdojnë keqpërdorimin papengesë. Ato nuk duhet të llogarisin me pasoja serioze. Andaj janë të nevojshme masat efikase për të ndaluar dumpingun në paga.

Dumpingu në Cyrih: mbi 100 000 franga pagë plotësuese

Një grup pllaka-ngjitësish kanë punuar që nga korriku në kantierin e

«Europaallee» tek nën-ndërmarrja e një firme pllaka-ngjitëse. Pagë nuk merrnin pothuaj se fare. Ata pos tjerash janë detyruar të falsifikojnë dokumentet, për të mos ra në sy dumpingu në paga.

3500 franga neto në muaj u ishin premtuar të 11 punëtorëve në Itali për punën që do të bënin tek një nën-ndërmarrje në Zvicër. Në vend të pagës së plotë atyre u janë pagua në dorë vetëm pak para pa kurrfarë dëftese.

Kur, për shkak të kontrolleve të mundshme, kjo taktikë shfave iu duk e sikletshme, me dinakëri përmes një mashtrimi të keq filluan të lëshojnë sipërfaqësisht dëftesa korrekte të pagave. Punëtorëve pllaka-ngjitës ua tregonin dëshminë e pagesës së bërë në bankë. Posa punëtorët nënshkruanin dëftesat e pagave të tyre si fatura, shefat prapë i anulonin pagesat në bankë.

Pagat plotësuese qysh para kërsëndellave

Pas një intervenimi të sindikatës

Unia, kontraktuesi i përgjithshëm – ndërmarrja Porr ka marrë përgjegjësinë mbi veti dhe është kujdesur që të zgjidhet shpejt ky rast i dumpingut në paga, mjerisht shumë i shpeshtë në këtë sektor.

Të prekurit kanë marrë shumë mbi 100 000 franga paga plotësuese deri para kërsëndellave, kështu që ata kanë pasur mundësi të kalojnë mirë festat e fundvitit. Përnjëherë ata janë të punësuar të drejtpërdrejtë të firmës pllaka-ngjitëse zvicerane dhe jo më nën-ndërmarrjes.

Deri në vitin 202 migrantet e migrantët (si sezonierë) ishin plotësisht të dorëzuar karshi ndërmarrësve. Me fuqizimin e lëvizjes së lirë të personave mes Zvicrës dhe BE-së, të drejtat e të punësuarve me sfond migracioni janë fuqizuar, me çka është shënuar një e arritur për punëmarrësit. Mirëpo, me kohë është rritur presioni në paga, andaj janë të nevojshme masat anësore dhe forcimi i tyre.

Kërkesat e Unia

Unia kërkon forcimin e masave anësore, pasi edhe përkundër ekzistimit të masave të tanishme anësore, kushtet e punëmarrësve në Zvicër janë duke u përkeqësuar dhe dumpingu në paga duke u shtuar. Për të mbrojtur më mirë punëmarrësit, Uni kërkon përmirësimet vijuese:

- Lehtësimin e vlefshmërisë së detyrimit të Kontratave Kolektive të Punës (KKP)
- Ndalesa e punëve me rastin e keqpërdorimeve
- Lehtësimi i qasjes nëpër ndërmarrje dhe nëpër kantiere
- Mbrojtje më e mirë e përfaqësuesve të personelit
- Detyrimi për bisedime
- Paga zvicerane tek mandatet publike
- Kontrolle të rrepta dhe sanksione më të fuqishme

Osman Osmani

Editorial



Me transparencë kundër dumpingut në paga

100 000 franga paga të mbetura duhet tu paguajë nën-ndërmarrja «Edil Service» të punësuarve të saj. Dumpingu në paga në vitet e fundit nuk është zvogëluar fare, përkundrazi. Të prekurit, kryesisht migrane e migrantë, të vetëm shpesh nuk mundin ti realizojnë të drejtat e tyre. Atyre u mbetet të shpresojnë se shefat e tyre herë do kur do tua paguajnë pagat e tyre. Shpesh presin gjatë, deri edhe kur ndërmarrjet falimentojnë, apo deri kur shefi zhduket tërësisht.

Shumë më mirë do të ishte, që të prekurit të mos presin por sa më parë të lajmërohen tek Unia, para se të bëhet. Pasi bashkërisht ne mund të angazhohemi për të drejtat e punëmarrësve. Ose drejtpërdrejtë para gjyqit, ose duke u kujdesur që të ndërmarrën kontrolle në ndërmarrje.

Mirëpo është e qartë: Edhe më mirë do të ishte, sikur dumpingu në paga të mos ndodh fare. Këtë duhet të ndërmjetësojë sistemi i ri ndërsektorial ISAB, i cili do të filloi të zbatohet qysh këtë vit. Në të ardhmen do të jetë e qartë qysh me rastin e dhënies së mandatit të punës, se a i është përmbajtur në të kaluarën firma në fjalë Kontratave Kolektive të Punës (KKP). Qëllimi është që mandatet e punës tu jepen vetëm ndërmarrjeve, të cilat u përmbahen KKP-ve, dhe kështu të rritet presionin karshi «deleve të zeza».

Unia është e bindur: Vetëm bashkërisht ne mund të pengojmë dumpingun në paga dhe konkurrencën e lirë: Fatmirësisht në ndërkohë ketë e kanë kuptuar edhe punëdhënësit: fale edhe presionit të punëtorëve të ndërtimtarisë dhe anëtarëve të Unia.

Lena Frank,
sekretare e sektorit të ndërtimtarisë

News

Politikat e migracionit dhe lëvizja e lirë e personave – vizionet sindikaliste?

Konferenca e migracionit e BSZ (Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës): E shtunë, me 30 mars 2019, 09.30–16.00 h, Restorant Mappamondo, Bernë
 Konferenca e sivjetme e migracionit e BSZ u drejtohet të gjithë anëtarëve dhe të interesuarve tjerë dhe do të trajtojë politikën e migracionit të Zvicrës. Të tri referatet prezantuese hyrës krijojnë kuptimin e përbashkët mbi zhvillimin historik dhe situatën aktuale. Do të ndriçohen konteksti ndërkombëtar (Marrëveshja kornizë me BE-në, Pakti i Kombeve të Bashkuara për migracionin) si dhe problemet e brendshme politike, siç është nisja e kufizuesve të Partisë Popullore të Zvicrës (SVP/UDC). Në grupet punuese dhe punëtorët pjesëmarrësit formulojnë kërkesat dhe vizionin për politikën emigracionit në të ardhmen. Me këtë rast do trajtojmë edhe sulmet raciste dhe diskursin në politikë dhe media. **Pjesëmarrja për anëtarë të sindikatave është falas. Lajmërimi bëhet në migration@unia.ch!**



Franshizat e larta janë të papërballueshme

Askund në Evropën perëndimore nuk paguajnë më shumë se në Zvicër të siguruarit nga gjepi i tyre për koston shëndetësore – shtu kësaj edhe premitë për kokë njeriu. Përzgjedhja e franshizës me këtë rast është po aq e mundshme sa edhe liria e të zgjedhurit për të shkuar tek mjeku. Një shkuarje – edhe përkundër mendimit vendor se në «shkojmë tek mjeku për çdo imtësi» – sipas OECD (Organizates për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) është shumë më e ulët se sa në vendet përreth (në Gjermani regjistrohen 10 vizita mjekësore në vit për kokë banori, ndërsa në Zvicër janë mezi 4 vizita). Pas një rrethi të Parlamentit federal edhe komisioni përgjegjës i dhomës tjetër donë që në të ardhmen të përshtatë koston e zhvillimeve të sigurimit themelor shëndetësor. Ky vendim është larg realitetit – se sa i përket situatës të siguruarve në Zvicër ashtu edhe përkitazi krahasimit me botën e jashtme.

Gjykata gjen shkelje në procedurë-konsultimin e shkarkimit masiv tek Elis Suisse SA

Në fund të 2017 ndërmarrja Elis Suisse SA iu bashkëngjiti selisë së vet në La Sarraz (VD), pa respektuar procedurën konsultative mbi shkarkimin masiv. Pas ankesës së Unia, gjykata e punës në Lozanë ka vërtetur shkeljen. Unia tani pret që shërbimi i tregut të punës të gjobojë ndërmarrjen e gabueshme. Unia përshëndet vendimin e gjyqit të punës dhe shpreh keqardhje për sjelljen e ndërmarrjes, e cila gjete tërë procedurës ka ndjekur një taktikë zvarritëse. Kjo sjellje nuk është e denjë për një ndërmarrje, e cila ka nënshkruar një Kontratë Kolektive të Punës dhe që përfiton nga tenderët publik. Unia kërkon nga shërbimi i tregut të punës së Kantonit Waadt që të gjobojë ndërmarrjen në fjalë. Gjopa në para mund të arrijë deri në 40 000 franga.

Puna temporale: KKP për personelin e huazuar KKP e re për personelin e huazuar nga 1 janari 2019

Qeveria federale Zvicrës ka deklaruar të vlefshme dhe të detyrueshme KKP-në për personelin e huazuar. Kështu, kjo KKP vlen për të gjithë Ndërmjetësuesit e personelit në Zvicër: Asaj i nënshtrohen mbi 360 000 punëmarrës.



Puna temporale

Rreth 360 000 njerëz punojnë në Zvicër si temporal – nëpër të gjithë sektorët. Kontrata Kolektive e Punës rregullon kushtet e punës për personelin e huazuar.

Puna temporale në Zvicër sa po vjen epokë rritet. Gjithmonë e më shumë njerëz punojnë me afat të kufizuar – qoftë në ndërtimtarinë, në industri, apo në profesionet e tjera shërbyese.

Kontrata Kolektive e Punës (KKP) u garanton të punësuarve temporal edhe më tej standarde të obligueshme minimale për kushte paga e pune, rregullim modern për sigurimin pensional profesional, një zgjidhje sektoriale për sigurimin e parave të mëditjes në rast sëmundjeje dhe një fond të veçantë trajnues. Kontrata vlen deri në fund të vitit 2020.

Paga më të larta minimale dhe Equal Minimum Pay

Partnerët social janë pajtuar mbi atë, se pagat minimale deri në fund të vitit 2020 të rriten për gjithsecilin prej 60 deri në 75 franga. Nga viti 2021 pos tjerash duhet të zbatohet parimi – Equal Minimum Pay në KKP për personelin e huazuar. Kështu për të punësuarit temporal do të vlejnjë të njëjtat paga minimale sikur për të punësuarit në marrëdhënie të pakufizuar pune – edhe në sektorët dhe ndërmarrjet, KKP-ja e të cilave nuk posedojnë KKP me vlefshmëri detyrimi të përgjithshëm. Në sektorët me KKP me vlefshmëri detyrimi të përgjithshëm aktualisht vlejnjë të njëjtat paga minimale për të punësuarit temporal sikur për ata me punësim të përhershëm.

Osman Osmani

KKP Ndërtimtarisë: Rezultati la vlen të luftohet!

20 runde bisedimesh dhe një luftë pune intensive ishin të nevojshme – tani më është e qartë: Nga 1 janari 2019 hyri në fuqi Kontrata e përgjithshme Kombëtare e Punës ekonomike e për Ndërtimtarinë, është siguruar pensionimi me 60 vjeç dhe punëtorët e ndërtimtarisë do të marrin një rritje korrekte të pagës.

Rezultati shkurtimisht

Pensionimi me moshën 60vjeç është siguruar dhe me disa përmirësime është ripërtërirë Kontrata e përgjithshme Kombëtare. Edhe punëtorët e ndërtimtarisë më në fund do të marrin rritjen ka kohë të merituar të pagës: Pagat në ekonominë kryesore të ndërtimit në vitin 2019 dhe 2020 rriten me nga 80 franga në muaj.

Presioni i punëtorëve të ndërtimtarisë ka ndikuar

Ia vlen të luftohet – këtë bindshëm e kanë dëshmuar vitin që lamë pas punëtorët e ndërtimtarisë. Kulmi i mobilizimit të madh të ndërtimtarisë e tregoi demonstrata e Cyrihut: me mijëra punëtorë ndërtimtarie nga e tërë Zvicra dolën në rrugë dhe demonstuan zëshëm për pensionet e tyre.

mtarie nga e tërë Zvicra dolën në rrugë dhe demonstuan zëshëm për pensionet e tyre.

Për dinjitetin dhe të drejtat e punëmarrësve

Më herët pronarët e ndërtimit për muaj të tërë kishin refuzuar bisedimet mbi sigurimin e pensionimit me 60 vjeç. Me këtë donin të arrinin një përkeqësim tek pensionimi i mëhershëm: Moshë pensionimi me 62 vjeç apo 30% pension më pak. Edhe tek KKP shtronin kërkesa brutale reduktuese, veçanërisht në kurriz të punëtorëve të shtyrë në moshë.

Ne nuk shantazhohemi!

Pas demonstratës pronarët e ndërtimit u

tërhoqën nga kërkesat e tyre radikale tek pensionimi i mëhershëm. Për të përfunduar Kontratën donin megjithatë të eliminonin rregullin e kohës të punës – dhe donin kështu të rrezikonin shëndetin dhe jetën e punëtorëve të ndërtimtarisë.

Lëvizja më e madhe protestuese në dhjetëvjeçarët e fundit

Mbi 15000 punëtorë të ndërtimtarisë në tërë vendin, pas kësaj në tërë vendin në muajt tetor e nëntor ndaluan punën. Ky ishte mobilizimi më i madh i punëtorëve të ndërtimtarisë që disa dekada. Edhe ishte një shenjë vendimtare, që tejkalonte sektorin e ndërtimtarisë: Të jesh bashkë ia vlen!

Osman Osmani



Pamje nga demonstrata e punëtorëve të ndërtimtarisë për mbrojtjen e pensionimit me 60 vjet dhe kundër perkeqësimeve në KKP

Greva e grave dhe dita e aksionit 14 qershor 2019 Kërkojmë! Respekt – pagë më shumë – kohë më shumë!

Kush mendon « AHV/AVS (Sigurimi i pleqërisë dhe trashëgimtarëve) ecën automatikisht », në pleqëri mund të befasohet keqas. Ia vlen të kontrolloni rregullisht konton tuaj të AHV/AVS. Këtu i keni të gjitha që ju nevojiten ti dini.

Në vitin e kaluar me 22 shtator për barazi në paga dhe kundër diskriminimit dolën në rrugë 20000 njerëz. Qysh gjatë fazës së mobilizimit ishte më se e qartë, se gratë edhe pas demonstratës duan të luftojnë edhe më tej dhe se janë të gatshme që të kërkojnë me këmbëngulje të drejtat e tyre. Për grevën e grave 2019 flitej gjithandej nga të gjithë dhe nuk mund të ndalet! Menjëherë pas demonstratës thuaja se në të gjitha Kantonet u krijuan lidhjet e grevës, pjesë e të cilave është edhe Unia. Rezulton qartë se: Gratë nuk do të lejojnë që edhe më tej të tërhiqen për hunde! Gratë e Unia me 14 qershor 2019 do të bëjnë grevë në tërë Zvicrën.

Respekt, pagë më shumë, kohë më shumë

Ne duam respekt. Kjo d.m.th. respekt për punën tonë dhe për shans të njëjta. Ne gratë kemi merituar edhe më shumë pagë. Ne duam barazi në paga dhe paga korrekte, të cilat mjaftojnë për jetesë. Ne gjithashtu kërkojmë një pajtueshmëri më të mirë dhe më shumë kohë për fëmijët tanë, familjen dhe shoqërinë si dhe qasje në trajnime-arsimore dhe perspektivë profesionale.

Ç'të bëjmë?

Greva – dhe ditët e aksionit janë të shumëllojshme: Ti me 14 qershor mund të bësh vetë grevë (p.sh. të zgjasësh



paузën e drekës) apo të marrësh pjesë në demonstratën, e cila mbahet në ora 15:30. Ti qysh tani mund të marrësh pjesë edhe në bimet regjionale të grevës, apo thjeshtë të bisedosh me koleget tua për grevën e grave dhe të organizoni bashkërisht një aksion në ndërmarrjen ku punon. Me 10 mars në Biel-Bienne mbahet një tubim nacional me qindra gra pjesëmarrëse – merr pjesë edhe Ti (nga ora 10-16 në Volkshaus Biel). Ne i gëzohemi pjesëmarrjes Tënde!

Corinne Schärer

A duhet të marrësh detyra punë në afat të shkurtë, andaj nuk mund të gësh përkujdesje për fëmijët? A fiton kolegu i punës më shumë se sa ti, edhe pse ju kryeni po të njëjtat punë? A e ke ndjenjën, se njerëzit e ndërmarrjes nuk kanë respekt për punën tënde? Të gjitha gratë njohin histori të tilla apo të ngjashme nga përditshmëria e tyre e punës. Shumëçka që gratë përjetojnë gjatë punës, mjerisht nuk janë raste të izoluara. Është me rëndësi që ne këto probleme ti bëjmë të dukshme, pasi ne vetëm kështu mund të përmirësojmë diçka. Na i trego neve përvojat tua. Në ueb faqen www.frau-streikt.ch (D) greve-feministe.ch (F) dhe scio-pero-delle-donne.ch (IT), mund të na i komunikosh përvojat tua.



womensmarch2019_ZH Foto@ida schmieder

Iniciativa për përgjegjësinë e korporatave Të thirren në përgjegjësi milionerët!

Korporatat zvicerane vazhdojnë të zënë titujt e lajmeve, sepse shkelin të drejtat e njeriut dhe të punës ose ndotin mjedisin. Iniciativa për përgjegjësinë e korporatave dëshiron t'i japë fund kësaj gjendjeje.

Puna e fëmijëve në plantacionet e kakaos, shfrytëzimi në fabrikat e veshmbathjes, lumenjtë e helmuar përgjatë minierave, dhunë kundër sindikalistëve aktiv – përsëritshëm ndërmarrjet zvicerane shkelin të drejtat themelore të njeriut me rastin e aktiviteteve sindikaliste në botën e jashtme (kështu edhe të drejtat e punëtorëve) si dhe rregullat e ndërmarrjeve. Vetëm gjatë viteve 2012 e 2017 janë të dokumentuara 62 shkelje nga ana e korporatave zvicerane – një për muaj! Në fakt dhe me të vërtetë numri i shkeljeve del të jetë shumë më i lartë.

Glencore, Nestle, Holcim ...

Posaçërisht me paskrupulli veprojnë korporatat e minierave dhe ato të përpunimit të lëndëve të para, si Glencore. Industriali, sindikata ndërkombëtare e

federatave të industrisë zbuloi vitin e kaluar se korporata nga qyteti Zug i Zvicrës në Republikën Demokratike të Kongos shkeli në mënyrë sistematike të drejtat e njeriut dhe ato të punëtorëve. Edhe ndërmarrjet tjera u kujdesen dhe vazhdojnë të kujdesen për tituj negativë. Kështu fjala bie korporata Nestlé (dhunë kundër sindikalistëve), apo korporata e çimentos LafargeHolcim, e cila anashkaloi në Indi rregullat themelore: vetëm në vitet 2016 dhe 2017 humbën jetën nga aksidenti në punë mbi 150 punësuar të korporatës.

Kush shkakton dëmin, duhet të përgjigjet

Sot ekziston një ligj, që i detyron ndërmarrjet, të respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat e punëtorëve kudo në

botë ku ato kryejnë veprimtarinë e tyre. Është shumë e vështirë, që nxirren para drejtësisë përgjegjësit në Zvicër për makinacionet e tyre në vendet tjera. Iniciativa për përgjegjësinë e korporatave donë të ndryshojë këtë gjendje. Ndërmarrjet që veprojnë në vendet tjera, e që kanë selinë në Zvicër, duhet të kujdesen, që të gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të biznesit të mos lëndojnë të drejtat e njeriut dhe të respektojnë rregullat e ruajtjes të mjedisit. Nëse korporatat e shpërfillin obligimin për vigjilencë të duhur, dhe nëse nga kjo shkaktohet dëm tek njerëzit dhe mjedisi, atëherë ato duhet të përgjigjen. Pasi, kush shkakton dëmin duhet edhe të merre përgjegjësinë!

Pepo Hofstetter

Bëhuni aktive tani!

Iniciativa për përgjegjësinë e korporatave (Kovi) është dorëzuar në tetor të vitit 2016 dhe tani është duke u shqyrtuar në parlament. Ajo është duke u mbështetur nga mbi 100 organizata, ndër të cilat edhe sindikata Unia dhe Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës. Parlamenti i Zvicrës në verën e kaluar ka vendosur për kundërpërpunimin, i cili marrë parasysh disa nga shqetësimet, mirëpo megjithatë kufizon disa nga fushat e veprimit. Edhe dhoma tjetër e Parlamentit do të diskutojë në pranverë mbi këtë çështje: Votimi mbi Iniciativën sipas të gjitha gjasave do të ndodhë në fillim të vitit 2020. Korporatat dhe lobi i tyre Economiesuisse e Swissholdings e luftojnë furishëm iniciativën. Ata e kundërshtojnë me duar e këmbë rregullat obliguese dhe janë kundër përgjegjësisë në rast shkeljeje. Mirëpo, siç tregojnë anketat, iniciativa gëzon një simpati të madhe në popullatë. Për të fituar votimin, është me rëndësi, qysh tani të jemi aktiv. Na nevojitet edhe mbështetja e juaj: Porosit pa pagesë flamujt e Kovi-Iniciativës apo Kovi – çantat dhe trego mbështetjen Tënde për këtë çështje të rëndësishme!

Iniciativa për përgjegjësinë e korporatave | initiative-multinationales.ch | iniziativa-multinazionali.ch/ | [facebook.com/konzerninitiative](https://www.facebook.com/konzerninitiative) | [facebook.com/initiativemultinationales](https://www.facebook.com/initiativemultinationales)

Pensionimi Kështu mund të shihni gjendjen e AHV/AVS suaj

Kush mendon «AHV/AVS (Sigurimi i pleqërisë dhe trashëgimtarëve) ecën automatikisht», në pleqëri mund të befasohet keqas. Ia vlen të kontrolloni rregullisht konton tuaj të AHV/AVS. Këtu i keni të gjitha që ju nevojiten ti dini.

Kush duhet të paguajë?

AHV/AVS është e detyrueshme për të gjithë personat, që jetojnë e punojnë këtu. Dhe kjo vlen nga 1 janari me mbushjen e moshës 17 vjeç dhe deri në moshën e pensionimit (64 vjeç për gra e 65 për burra). Ata që nuk janë në marrëdhënie pune duhet të paguajnë kontribute nga ditëlindja e 20. Të obliguar të paguajnë kontribute janë edhe kaluesit ndërkufitar dhe punëmarrësit sezonal, për kohën sa janë në marrëdhënie pune në Zvicër. Edhe për personat që punojnë në amvisni private si dhe artistët/et sigurimi i AHV/AVS është obligues.

Përjashtimi nga sigurimi detyrues

Ekziston një përjashtim: Nëse fitoni më pak se 2300 franga në vit tek punëdhënësi i njëjtë, ai mund të heq dorë nga ndalesat e kontributeve të AHV/AVS. Për punëmarrësit kjo në asnjë rast nuk shpaguehet, pasi më pas tek përllogaritja e pensionit mungojnë kontributet: Kërkoni në mënyrë eksplicite edhe tek «pagat tejet të ulëta», edhe për ato nën 2300 franga të bëhet deduksioni (zbritja nga paga) për sigurimin e AHV/AVS.

Deduksioni

Punëmarrësve u zbriten kontributet drejtpërdrejt nga paga. Punëdhënësi gjithashtu paguan shtesë po të njëjtën shumë: Zbritja për sigurimin AHV/AVS është 8,4% e pagës, gjysmën e paguan9i ju gjysmën tjetër punëdhënësi. Pos kësaj zbriten edhe 1,4% për sigurimin e invaliditetit IV/AI dhe 0,45% për EO/APG (kompensimi i të ardhurave të humbura)

Personat jo – të punësuar

Amviset dhe amvisët, pensionistët e IV/AI dhe studentët duhet gjithashtu të paguajnë kontribute në sigurimin e AHV/AVS, IV/AI dhe EO/APG, edhe kur nuk kanë të ardhura. Ato llogariten në lidhje me pasurinë: Kontributi minimal është 482 franga në vit, ndërsa më i larti 24100 franga. Tabela aktuale: www.ahv-iv.ch/p/2.03.d.

Të pavarurit

Si i punësuar i pavarur paguani tërë shumën ju vet, varësisht nga të ardhurat e fituara nga puna dhe kapitali personal mes 5196 dhe 9,65%. Kësaj shume duhet shtuar edhe kontributet për shtesat familjare dhe administratën e Entit të sigurimeve shoqërore. Nëse keni pësuar humbje, atëherë paguani vetëm shumën minimale.

Divorci

Me rastin e divorcit xhiro-llogarit e AHV/AVS ndahen. Kjo d.m.th., që të dy bashkëshortët duhet të ndajnë përgjysmë kontributet e tyre gjatë bashkëshortësisë. Ata mund të kërkojnë ndarjen e kontributeve të kursyera edhe tek me rastin e pensionimit, mirëpo ia vlen që ato të ndahen menjëherë pasi divorci të jetë i plotfuqishëm. Kontrolloni se a janë llogaritur e evidentuar saktë kontributet dhe sigurohuni se a janë regjistruar me korrektësi edhe kreditë për rrituese në rast edukimi e përkujdesjeje.

Të martuarit jo – të punësuar

Nëse bashkëshorti/ja apo partneri/ja juaj ka paguar dyfish kontributin minimal në AHV/AVS, ju nuk duhet të bëni pagës shtesë, nëse nuk jeni në marrëdhënie pune. Aktualisht janë 964 franga. Posa të pensionohet personi që ka paguar kontribute, atëherë duhet edhe personat e martuar, qofshin ata edhe jo – të punësuar, të paguajnë kontribute vet. Mos harroni të lajmërohni menjëherë tek Enti i sigurimeve shoqërore.

Kredia përfituese e edukimit dhe përkujdesjes

Nëse keni fëmijë (edhe të adoptuar), apo nëse kujdeseni për një anëtar familje me nevoja, mundeni të përllogaritni kredinë përfituese të edukimit apo përkujdesjes. Këto janë të ardhura fiktive, që juve ju takojnë tek përllogaritja e pensionit tuaj. Kredinë përfituese e merrni, nëse ju jeni kujdestari i ligjshëm. Nëse këtë e kanë të dy prindërit, atëherë u përllogariten të dyve përgjysmë. Tek divorcet apo të pamartuarit ndarja bëhet në bazë të kontributit të përkujdesjes.

Boshllëqet e kontributit: Kërkoni një ekstrakt

Boshllëqet në AHV/AVS janë me pasoja për pensioni tuaj. Ju mund të kontrolloni, se a kanë paguar të gjithë punëdhënësit tuaj kontributet e AHV/AVS në mënyrë korrekte: rebrand.ly/kontoauszug. Nëse keni boshllëqe në kontribute, të cilat nuk janë më të vjetra se 5 vjet, atëherë këto mund ti mbyllni. Dhe atë, duke paguar mungesën e kontributit minimal vjetor të AHV/AVS.

Llogaritja

Për të ditur, se si do të qëndroni financiarisht në moshën tuaj të pleqërisë, mund të kërkon në çdo kohë një ekstrakt të AHV/AVS. Se si mund ta bëni këtë mund të mësoni këtu: <http://acor-avs.ch/conditions>. Për më shumë informata: www.ahv-iv.ch

Work, Sina Bühler 3 nëntor 2017 (adaptoi Marília Mendes)

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Dëftesa e punës: ç 'duhet bërë nëse firma kundërshton ta lëshojë atë?

Unë kam ndërruar vendin e punës dhe kam kërkuar nga ish firma ime një dëftesë pune. Edhe përkundër kujtesës së përsëritur që ia kam bërë firmës, megjithatë ende nuk kam marrë dëftesën. Unë kam të drejtë në dëftesë pune, apo jo?



Philip Thomas: Po. Pas përfundimit të marrëdhënies së punës, firma e juaj e mëparshme duhet tua lëshojë një dëftesë pune. Bazuar në të drejtën obliguese ju keni të drejtë ligjore për dëftesë. Pasi deri më sot nuk keni marrë dëftesën tuaj të punës, atëherë mund të përpiloni vet një propozim dëftese pune dhe informoni shefin apo shefen tuaj të mëhershme se do ta padisni, nëse nuk ua dërgon dëftesën e punës. Nëse nuk arrihet marrëveshja, duhet të ndërmerrni hapi ligjor. Fillimisht duhet të nisni një procedurë pajtimi dhe nëse aty nuk arrihet pajtimi, duhet të thirrni gjyqin kompetent. Në një rast të tillë më së miri është të drejtoheni tek sekretariati i Unia të regjionit tuaj. Aty ju ndihmojnë më tutje.

Work, 16.12.2018

Përfitimet suplementare: A duhet unë ti kthejë ato?

Ka një kohë të gjatë që unë marrë një pension të plotë invaliditeti. Pasi ky pensioni imi është i pamjaftueshëm, unë marrë edhe shtesë suplementare. Tani kam trashëguar 50000 franga. A duhet tani të kthejë prapa përfitimet shtesë (suplementar) që kam marrë deri më tash?

Philip Thomas: Jo. përfitimet suplementare nuk duhet të kthehen. Kjo shpesh ngatërrohet me ndihmat sociale. Ato në një rast të tillë duhet të kthehen. Përfitimet suplementar duhet të kthehen, vetëm në rast se ato janë marrë për shkak të fakteve të reme. Këto raste janë, kur fshehët pasuria, apo kur si pensionist invaliditeti nuk deklaroni të ardhurat e mundshme shtesë. Ose nëse nuk lajmëroni përshtatjen e mundshme të qerasë. Tani ju duhet gjithsesi ti lajmëroni Arkës së fondit të kompensimit, që keni trashëguar 50000 frangat. Përndryshe shkëlqen detyrimin ligjor që keni për ti lajmëruar ato. Arka e fondit të kompensimit në bazë të situatës suaj të re financiare përllogarit të drejtën e juaj të mundshme për përfitimet shtesë. Është e mundur që tani e tutje të merrni më pak përfitim suplementar, apo edhe më të mos keni të drejtë fare në to. Nëse nuk e bëni lajmërimin, arka e kompensimit herëte a vonë gjatë kontrollit periodik të gjendjes suaj personale dhe ekonomike do ta vërejë, dhe kjo do të ketë si pasojë kthimin e tyre.

Work, 16.12.2018

Aktivisti dhe sindikalisti i palodhshëm Remo Schädler ka ndërruar jetë

Një grup sindikalistësh shqiptarë një herë në vit kuvendojnë shtruar për aktualitetin dhe të ardhmen e këtij komuniteti në Zvicër. Sivjet ata u takuan në Lozanë. Lista e synimeve të tyre është e gjatë dhe e rëndë.

Të martën e 15 janarit 2019, pas një sëmundje të rëndë vdiq kolegu dhe shoku ynë Remo Schädler.

Remo ka punuar që nga që nga viti 2003 për lëvizjen sindikaliste, fillimisht më 2004 deri në fuzion tek SMUV (Sindikata e Industrisë, Tregtisë dhe Shërbimeve), e më pastaj tek sindikata Unia. Si sekretar regjional në Unia Cyrih-Shafhausen ai ka dhënë kontribut të konsiderueshëm që kjo njësi sindikaliste regjionale të rrisë anëtarësinë, të jetë më ofensive dhe më e suksesshme.

Remo ka bërë punë të shkëlqyer në lami të ndryshme

Ai është angazhuar aktivisht edhe për të drejtat e migrantëve/eve: Për vite të tëra ka udhëhequr me shumë sukses grupin e interesit (GI) të migracionit në Unia Cyrih-Shafhausen. Nën drejtimin e tij GI migracion Cyrih-Shafhausen ishte ndër grupet më aktive të migracionit në Unia të gjithë Zvicrës. Remo ka marrë pjesë rregullisht në aktivitete tjera tradicionale si «Vrapimi kundër racizmit» në Cyrih dhe kishte organizuar edhe ditën ndërkombëtare

të migracionit në Cyrih. Ai gjithmonë ishte i hapur për nevojat e migrantëve dhe dëgjonte me vëmendje shqetësimet e tyre. Angazhohej pa përtesë dhe spontanisht për si për preokupime të komuniteteve të caktuara të migrantëve, pa dallim prejardhjeje.

Remo dhe aktivistët sindikalistë shqiptarë

Remo ka mbështetur aktivisht dhe pa rezervë edhe krijimin dhe fuqizimin e grupit sindikalist të shqiptarëve në regjionin e Unia Cyrih-Shafhausen. Falë edhe mbështetjes së Remos, aktivistët e mirënjohur sindikalistë shqiptarë të këtij regjioni janë ndër më të dalluarit në gjithë sindikatën Unia dhe pjesëmarrës në të gjitha aksionet e protestat sindikaliste pa marrë parasysh degën ekonomike, sektorin apo edhe grupin sindikalist të interesit. Lidhjet e tija indirekte me shqiptarë, konkretisht me Shqipërinë, si i majtë politik që ishte, datojnë që nga rinia e tij e hershme.

Remo arriti të bëjë institucion në veti

Remo angazhohej me zemër e shpirt në rrugë, në kantiere si dhe në bisedime



për të përfaqësuar interesat politike të sindikatës dhe për të avancuar të drejtat e të gjithë migrantëve. Remo ka gëzuar besimin e të gjithëve dhe pikërisht angazhimi i tij në aktivitete të panumërta sociale dhe kulturore e bërë atë një institucion të qëndrueshëm në regjionin e Cyrihut. Ne ndajmë dhimbjen me gruan, fëmijët dhe me të gjithë të dashurit e tij, ndërsa të gjithë të prekurve dhe të pikëlluarve u dëshirojmë forcë për tu përballuar me këtë humbje të madhe.

Osman Osmani

Zgjedhjet për Parlamentin e BE-së Evropës i nevojitet një parlament më social

Mes datës 23 dhe 26 maj qytetarët/et e BE-së do të zgjedhin Parlamentin e BE-së. Përse kjo është me rëndësi edhe për një vend si Zvicra, që nuk është në BE. Edhe shtetasit/et e BE-së, që jetojnë këtu, mund të marrin pjesë në to. Si duhet të veprojnë?

Përse janë më rëndësi votimi?

Parlamenti i BE-së luan një rol vendimtar sa i përket ligjeve në BE. Praktiki është për të gjitha Rregulloret nevojitet aprovimi i Parlamentit. Nëse një propozim ligji refuzohet nga parlamenti i BE-së, atëherë ai nuk do hyjë në fuqi. Pos kësaj deputetët e parlamentit të BE-së vendosin mbi financat dhe mbi përbërjen e qeverisë (komisionit) së BE-së. Se në cilin drejtim do të shkojë BE në 5 vitet e ardhshme, gjithashtu do të vendoset në kutitë e votimit për Parlamentin e BE-së.

Si është e prekur Zvicra?

Përmes marrëveshjeve të ndryshme bilaterale, Zvicra është e obliguar që të merre përsipër bile edhe legjislacionin e BE-së. Andaj nuk është me rëndësi vetëm për të gjithë shtetasit/et e BE-së, por edhe për zvicranët/et shumë me rëndësi, se kush do të jetë përgjegjës për ligje e BE-së në 5 vitet e ardhshme.

Zhvillime shqetësuese

Zhvillimet aktuale politike, mjerisht japin shkas për shqetësim. Gjithandëj nëpër BE janë në rritje forcat radikale.

Ato konsiderojnë të arriturat sociale, siç janë sigurimet shoqërore dhe të drejtat në punë si një kërcënim. Ato nxisin frikë nga migrantët/et dhe angazhohen për politika nacionaliste e egoiste. Ato konsiderojnë, fjala bie barazinë e grave si sulm ndaj «vlerave tradicionale». Andaj është me rëndësi, të votojmë për ata/o që angazhohen me efektivitet edhe për të drejtat e pakicave dhe të atyre që janë më të dobët si dhe që luftojnë për të drejta të punëmarrësve dhe për një Evropë sociale.

Të votohet për një Evropë më sociale

Votimet mbahen nga 23 – 26 maj (secili shtet përcakton vet datën e saktë të votimit). Qytetarët/et e BE-së, edhe nëse banojnë në Zvicër, kanë mundësinë që voton e tyre ta japin për një Evropë më sociale. Së pari ata/o që kanë të drejtë vote, fillimisht duhet të sigurohen se janë të regjistruar. Secili vend ndjek procedurat e veta. Se si kjo funksionon ne secilin vend të veçantë të BE-së mund të mësoni në vegën vijuese:

Vlen edhe për bashkëkombësit/et shqiptarë/e që posedojnë edhe shtetësinë e ndonjërit nga vendet e BE!

Marek Wieruszewski (përshtatur nga O. Osmani)

Elections to the European Parliament 23 – 26 May 2019			
How to vote from Switzerland			
You are from:	Available means:	Deadline to enrol in the register:	Information on voting procedures:
Belgium	Internet, Mail, In person	31.01.2019	www.diplomatie.belgium.be
Bulgaria	Internet, Mail, In person	2.06.2019	www.ek.be/bulgaria
Czech Republic	Internet, Mail, In person	24./25.05.2019	www.czechembassy.be
Denmark	Internet, Mail, In person		www.embassy.dk
Germany	Internet, Mail, In person	5.05.2019	www.bundeswahlleiter.de
Estonia	Internet, Mail, In person	26.4.2019	www.valimiseregionid.ee
Ireland	Not possible		
Greece	Internet, Mail, In person	TBC	www.mfa.gr/embassy/embassy-switzerland
Spain	Internet, Mail, In person		www.exteriores.mta.es/embajada/ingles
France	Internet, Mail, In person	31.03.2019	www.ambafrance.ch
Croatia	Internet, Mail, In person	10 days before the elections	www.embassy.hr
Italy	Internet, Mail, In person	No need to enrol	www.ambascia.ester.it
Cyprus	Internet, Mail, In person		http://www.mfa.gov.cy/mfa/embassies/embassy_cyprus.mfa/
Latvia	Internet, Mail, In person		www.mfa.gov.lv/de/ambatt
Lithuania	Internet, Mail, In person		www.ria.mfa.lt